

Angazhohu Monitoro Vepra



SUPLEMENT NGA GRUPI MONITORUES I KËSHILLIT BASHKIAK,
POGRADEC, NËNTOR 2012

*Le të monitorojmë së bashku,
të këshillojmë njëri-tjetrin,
të rritemi me qytetin!*

Monitorimi
i Këshillit
Bashkiak,
Pogradec
Dosja Nr. 7,



GRUPET E INTERESIT NË NDRYSHIMIN

E NIVELIT TË TAKSAVE.....faqe 5

1 VIT KËSHILLI BASHKIAK.....faqe 6-7

INTERVISTË ME KRYETARIN E BASHKISË SË POGRADECIT,
Z. ARTAN SHKËMBI.....faqe 8-9

BUXHETIMI ME PJESËMARRJE.....faqe 10

I DASHUR QYTETI IM!faqe 12

**ZGJIDHNI QUITZ NË FAQEN 11 DHE MERRNI NJË DHURATË NGA
GRUPI MONITORUES**

FOTO NGA MONITORIMI I KËSHILLIT TË BASHKISË



PUSHTETI VENDOR

Vëzhgim

Grupet e interesit në ndryshimin e nivelit të taksave

Dhimitër Gegprifti

Ndryshimi i nivelit të taksave dhe tarifave të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit ishte një nga shtatë projektvendimet e miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec, i datës 15 nëntor 2012, paraqitur nga nënkryetari dhe drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, z. Paskalino Ziko.

Një ndryshim i tillë mbështetet në bazën ligjore të 8652, datë 31.07.2000 në nenin 8, pika 1, paragrafi III, shkronja “b” e në vazhdim, në Ligjin 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave Vendorë” i ndryshuar, në Ligjin 10119 “Për planifikimin e territorit” dhe VKM, nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores uniformë të kontrollit të zhvillimit të territorit”. Në këtë projektvendim përfshihen 7 lloje taksash dhe tarifash: tarifa për planet vendore, taksa e ndikimit në infrastrukturë me nënlojet e saj, për sipërfaqe fasade, tarifa e aplikimit për lejë ndërtimi, për lejë përdorimi, për lejet e kontrollit.

Nga një vëzhgim qytetar na lind e drejta të diskutojmë rreth këtij projektvendimi: -Së pari, a është marrë mendimi, a është diskutuar me grupet e interesit, në rastin tonë, firmat

ndërtuese, ndërtuesit vetjak. Ndryshimi i nivelit për tarifën e aplikimit për lejë zhvillimi e ndërtimi, nuk thuhet në relacionin shoqërues të ndryshimit të taksave dhe tarifave. Sa ka qenë, sa është ndryshuar? E njëjta gjë edhe për tarifën e aplikimit për lejë përdorimi. Ndryshimi i ri i taksave dhe tarifave për Planifikimin dhe Kontrollin e Zhvillimit nuk të jep mundësi të



krijosh një ide të saktë për vlerën totale të një ndërtimi në procesin fillestar, qoftë ky vetjak, banesë kolektive, hotelerie apo biznesi. Ndryshimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 2 %, 2.5 % në 3 % argumentohet me ligjin

e ri, “Për planifikimin e territorit”, i cili “rrezon konceptin e zonës qendër dhe e ndan territorin në nënjesi strukturore, është rritur kostua e mirëmbajtjes, kostua e investimeve në infrastrukturë.

Ndikimi i ndërtimeve të reja është më i madh se më parë, pasi janë shtuar në mënyrë të ndjeshme sipërfaqet mbi të cilat janë realizuar investimet në infrastrukturë. “Viti 2012 është një vit i vështirë nga ana financiare ashtu dhe viti, që lamë pas 2011. Kriza financiare vazhdon akoma në vendin tonë, në Evropë dhe në Botë. Në kushtet e një krize financiare globale, e cila ka prekur bizneset, institucionet, familjet, jemi duke përjetuar një vit shumë të vështirë financiar dhe në institucionin tonë”. Kështu e fillon dhe e argumenton analizën financiare 6-mujore, janar-qershor 2012 Bashkia Pogradec. Nuk thuhet si shfaqet kjo krizë në institucionin e Bashkisë konkretisht, ç’bëhet për minimizimin real të saj? Do të ishte më mirë që kjo gjendje të merrej në konsideratë, kur mendojmë dhe veprojmë për rritje taksash dhe tarifash, duke mos harruar dhe situatën në shkallë vendi në këtë fushë.

Vetëm këshilltarët pa grupet e interesit, pa pjesëmarrje publike, nuk mund ta përfaqësojnë interesin publik.

1 vit Këshilli Bashkiak

Ka funksionuar fryma e bashkëpunimit

Intervistë me këshilltaren znj. Natalja Vreto

Për pyetjen “Çfarë përshtypjesh keni për punën 1-vjeçare të Këshillit Bashkiak”, znj. Natalja Vreto na shpjegon:

Si anëtare e re e Këshillit Bashkiak, ajo jep përshtypjet e saj për punën 1-vjeçare, ku thekson se ka fituar eksperiencë dhe i ka vlejtur kjo për jetën e saj. Këshilli ka funksionuar normalisht, komisionet gjithashtu kanë trajtuar çështje të ndryshme, që kanë të bëjnë me interesimin e qytetarëve. Përgjithësisht, ka funksionuar fryma e bashkëpunimit dhe e mirëkuptimit për çështje të rëndësishme midis anëtarëve.

Cili ka qenë diskutimi më i debatuar gjatë mbledhjeve tuaja dhe si e zgjidhët atë?

Rritja e çmimit të ujit, i menjëhershëm ka qenë diskutimi më i debatueshëm gjatë punës 1-vjeçare. Znj. Natalja shprehet se ka qenë kundër rritjes së çmimit, sepse kjo prek drejtpërdrejt ekonominë e familjeve në nevojë, po kështu ndryshimi i tarifës së ujit kërkohej në një moment kur kriza ekonomike kishte shtrirë ndikimin e saj dhe kur treguesit e ndërmarrjes flisnin për keqmenaxhim, pasi sasia e ujit që nuk faturohej përbënte mbi 40 % të sasisë së ujit të prodhuar.

Pra, po kërkohej rritja e tarifës së ujit për të mbuluar humbjet në rrjet.

E njihni botimin tonë “Angazhohu – Vepro - Monitoro”, nëse jo, pse? Nëse po, cili është opinion tuaj mbi angazhimin tonë, ndonjë sugjerim i mundshëm?

Natyrisht që e njoh grupin monitorues dhe botimin “Angazhohu- Vepro - Monitoro”. Shumicën i kam pasur nxënës dhe me vjen mirë që një grup të rinjsh si ju, kanë ndërmarrë një nismë të tillë dhe që i shikojnë ngjarjet, debatet apo diskutimet e Këshillit Bashkiak pa ngjyrimet politike. Jeni gjithmonë të pranishëm në mbledhjet e këshillit bashkiak, punoni me përkushtim dhe seriozitet, për të përmbushur detyrën që keni marrë përsipër.

-Ju falënderoj për këtë nismë dhe ju uroj suksese të mëtejshme!

Intervistoi: Mariglen Vreto

INTERVISTA

1 vit Këshilli Bashkiak

Gjithmonë vendos forca e kartonit!

Intervistë me këshilltarin z. Vangjo Gusho

1. Çfarë përshtypjesh keni për punën 1-vjeçare të Këshillit Bashkiak?

Këshilli i Bashkisë Pogradec është produkt i një përplasje të fortë që u bë gjatë fushatës elektorale. Si një produkt i përplasjeve të forta, jehona do të ndihet edhe në funksionimin e Këshillit të Bashkisë.

Nuk kanë qenë të pakta rastet kur palët, të përfaqësuara nga të dy grupimet më të mëdha, Aleanca për të Ardhmen dhe Aleanca për Qytetarin, nuk kanë qenë dakord me njëra-tjetrën, pasi vinin në këshill si përfaqësuese të programeve të ndryshme.

Fakti që Aleanca për Qytetarin ka shumicën absolute, shpeshherë i bën mbledhjet e Këshillit të bashkisë të tilla që çfarëdo që të thuash, askush nuk të dëgjon.

Çdo gjë është e paravendosur dhe debatet që mund të bëhen janë të pavlera.

Nuk mbaj mend, personalisht, që të jetë marrë në konsideratë ndonjë ide apo propozim i bërë nga këshilltarët e Aleancës për Qytetarin. Janë hedhur poshtë me forcën e kartonit. Gjithmonë vendos forca e kartonit.

Rasti i mbledhjes së fundit, në projektvendimin për dhënien e titujve për qytetar nderi, nuk u morën

Nga Alban Gusho

konsideratë dhe as nuk u hodh në votim, asnjë prej propozimeve të këshilltarëve të grupit të Aleancës për Qytetarin. Mesa duket vendimet merren përpara se të vihet në mbledhje.

2. Cili ka qenë diskutimi më i debatuar gjatë mbledhjeve të Këshillit dhe si e zgjidhët atë?

Diskutimi më i madh ka qenë buxheti i bashkisë. Aty shfaqen vizionet e ndryshme që kanë grupet e ndryshme politike për zhvillimin e qytetit. Megjithë debatet që janë bërë, ku ka pasur ide dhe mendime me vlerë të individëve dhe grupeve politike, por edhe të këshilltarëve brenda grupit të Aleancës për të Ardhmen, që kanë shumicën, në asnjë rast nuk është marrë në

konsideratë asnjë propozim. Janë votuar vetëm variantet e projektvendimeve që vijnë të gatshme nga administrata e bashkisë. Kjo mënyrë e të sjellurit e minimizon rolin e Këshillit të Bashkisë dhe shpeshherë të krijohet përshtypja që organet e emëruara kanë më tepër pushtet se organet e zgjedhura.

3. E njihni botimin tonë "Angazhohu - Vepro - Monitoro"? Nëse po, cili është opinionin tuaj mbi angazhimin tonë, ndonjë sugjerim i mundshëm?

Jam në dijeni të suplementit dhe më ka lënë përshtypje të mira. Opinioni i grupit duhet të bëhet publik. Duhet të jetë më tepër prezent në media, duke u përpjekur të jepet një mendim mbi palët.

I përkas brezit dhe mendimit ndryshe nga ai autoritar

Intervistë me këshilltarin z. Leonard Berberi

1- Çfarë përshtypjesh keni për punën 1-vjeçare të Këshillit Bashkiak?

Është shumë e rëndësishme të theksoj se puna 1-vjeçare në Këshillin Bashkiak ka qenë intensive, me shumë diskutime, të cilat kanë ngjallur disa herë edhe debate konstruktive. Vetë përbërja aktuale e anëtarëve të orienton drejt bashkëpunimit dhe mirëkuptimit. Është e vërtetë që eksperiencia e këshilltarëve të vjetër, si Hasan Laho, Syrja Palla, Petro Stefani dhe Thoma Angjellari kanë luajtur një rol kyç në mbarëvajtjen e komisioneve, trajtimin të çështjeve në mbledhjen e këshillit duke e orientuar atë drejt zgjidhjes optimale në interes të qytetarit.

Pjesëmarrja e konsiderueshme e grave, gjithashtu ka ndikuar në një klimë më të butë dhe të pranueshme të diskutimeve në të dyja nivelet, në komisione dhe mbledhje këshilli.

Unë i përkas një grupi të rinjsh që i janë bashkuar Këshillit Bashkiak për herë të parë, të cilët kanë një bagazh

të mirë shkollash dhe eksperiencë në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky grup ka ndikuar shpeshherë në mendimin bashkëkohor në formën e diskutimit dhe krahasimit të trajtimit të çështjeve të ndryshme, si: Klubi Sportiv i Futbollit Pogradeci, pjesëmarrja dhe detyrimi ndaj Qarkut Korçë, ngrohja e shkollave gjatë dimrit, si dhe investimi për blerjen e matësve elektronikë për ndërmarrjen "UK" sh.a Pogradec.

2- Cili ka qenë diskutimi më i debatuar gjatë mbledhjeve të Këshillit dhe si e zgjidhët atë?

Diskutimi më i debatuar ka qenë Buxheti i vitit 2012, në zërin Investimi i rreth 33.000.000 Lek të reja për KSF Pogradeci, në një kohë krize financiare për Bashkinë Pogradec, e cila mbart detyrime ndaj firmave private të ndërtimit, të cilat kanë investuar në rrugët e qytetit, duke i detyruar ato të paguajnë interesa pa fund në bankat respektive, ku ato janë detyruar të marrin kredi për të përmbushur



detyrimin kontraktor. Lidhur po me këtë temë, unë kam diskutuar shumë fort në Komisionin e Ekonomik-Financës për mosaprovimin e kalimit të tepricës në KSF Pogradeci në vlerën prej rreth 3.200.000 lekë të reja, të mbetura nga Buxheti për vitin 2011, kur ne tashmë kishim akorduar një vlerë relativisht të madhe për vitin 2012.

I kam kërkuar komisionit edhe këshillit ta akordojnë këtë shumë në dy drejtime kryesore:

1. Të shtojmë fondin e blerjes për lëndën djegëse në shkollat, kopshtet, dhe të vetmen çerdhe që i ka mbetur Pogradecit.

2. Të përdoret për të likuiduar detyrimet ndaj firmave private, ose investime në bibliotekë apo për një ambient social për të moshuarit.

Sa për të zgjidhur, vlen të theksohet se edhe pse shumica e anëtarëve të

këtij komisioni ishin plotësisht dakord që nuk duhej investuar një shumë e tillë vetëm për vitin 2012 ndaj KSF, edhe për fondin e mbartur nga viti 2011, ata votuan PRO pas një takimi partiak para votimit në këshill.

3- E njihni botimin tonë "Angazhohu - Vepro - Monitoro", nëse jo pse? Nëse po, cili është opinionin tuaj mbi angazhimin tonë, ndonjë sugjerim i mundshëm?

Natyrisht që e njoh shumë mirë botimin tuaj dhe e vlerësoj pjesëmarrjen e rinisë dhe të rinjve, të cilët duan të bëjnë një jetë aktive dhe të mirinformuar mbi ngjarjet dhe zhvillimet, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në të ardhmen e qytetit të tyre. Unë i përkas brezit dhe mendimit ndryshe nga ai autoritar, i orientuar dhe i detyruar nga Partia, e aq më tepër nga interesa personale për përfitim vetjak në këmbim të votës.

E vlerësoj pjesëmarrjen tuaj në çdo mbledhje, mënyrën se si bëni shkrimet tuaja në këtë botim të përmuajshëm, si dhe temat të cilat trajtoni, e bëni në mënyrë profesionale.

Përsa i përket sugjerimit, do t'ju sugjeroja të merrnit pjesë në komisionet e këshillit dhe t'i pasqyroni ato në mënyrë konstruktive.

INTERVISTA

Minoranca vepron nën urdhrat e Partisë dhe të deputetit

Intervistë me Kryetarin e Bashkisë së Pogradecit, Z. Artan Shkëmbi

Nga Dorian Leka

1. Çfarë përshtypjesh keni për punën 1-vjeçare të Këshillit Bashkiak?

Është Këshilli i tretë bashkiak që më është dashur të punoj gjatë viteve të punës si kryetar bashkie. Besoj se tashmë përvoja më bën të gjykoj qartë për nivelin dhe përkushtimin e anëtarëve të Këshillit nga njëri mandat në tjetrin. Sigurisht, që nuk mund të jap një gjykim bardhë e zi, por nëse do të shprehesh shkurt, do të thoja që përbërja e këtij Këshilli është më e mirë se ajo e dy këshillave paraardhës, mungon përvoja sepse shumica e anëtarëve të Këshillit janë për herë të parë të zgjedhur, por përkushtimi dhe angazhimi është më i madh se ai i anëtarëve të Këshillave paraardhës. Sigurisht, që nuk mund të pritët që 25 anëtarë të jenë aktivë. Zakonisht rreth 30% e anëtarëve janë shumë aktivë dhe të tjerët jo tepër pjesëmarrës në diskutime (kjo ndodh në çdo Këshill, madje edhe në Parlament). Në këtë Këshill ve re pjesëmarrje më të madhe në diskutime, gjë që është një vlerë e shtuar e tij.

2. Cili ka qenë diskutimi më i debatuar gjatë mbledhjeve tuaja dhe si e zgjidhët atë?

Në marrëdhëniet e mia me Këshillin, i ndaj qartë kompetencat e mia dhe të Këshillit. Administrata ka të drejtën e propozimit dhe Këshilli ka të drejtën e miratimit. Asnjë vendim nuk e kam konsideruar të vështirë për tu miratuar, sepse për asnjë vendim nuk e kam konsideruar të domosdoshëm miratimin e tij, sipas propozimit tonë. Në çdo rast, ne jemi të hapur për vërejtjet, sugjerimet, ndryshimet dhe përmirësimet që mund t'i bëhen një projekt-vendimi. Pra, në çdo rast ne parashtrijmë para Këshillit projektin tonë dhe në çdo rast jemi të hapur për vendimin që do marrë Këshilli. Zakonisht, miratimi i buxhetit është me i debatuar, por edhe në këtë rast ne gjithmonë jemi të hapur për propozimet e bëra nga anëtarët e Këshillit për përmirësimin e tij.

3. Jemi të informuar se këshilli bashkiak dhe kryesia e tij ka patur raste kur për çështje vendimtare ka votuar edhe unanimisht, gjë që tregon një harmoni duke shpërfillur interesat partiake të këshilltarëve. Sa shpesh ka ndodhur dhe si është arritur kjo?



Nuk besoj se ky Këshill shquhet për "harmonin", apo për vënien e interesave të qytetit para atyre të partisë. Është votuar unanimisht vetëm për vendime jo të rëndësishme. Duhej të ishte votuar unanimisht për shumë më tepër vendime që u shërbejnë qytetarëve dhe qytetit, por kjo nuk ka ndodhur, sepse minoranca e Këshillit në shumicën e rasteve vepron nën urdhrat e Partisë dhe të deputetit dhe jo duke parë interesat e qytetarëve. Gjithsesi, vendimet miratohen, sepse shumica është e përgjegjshme mjaftueshëm ndaj interesave të qytetit.



4. Shpeshherë kemi vënë re një heshtje të këshilltarëve, komisione që nuk janë mbledhur sipas datave të përcaktuara, apo deri te hezitime për të përmbyllur diskutime të gjata dhe për të kaluar të votimi, si mjeti më i favorshëm për t'u larguar më shpejt nga salla. Si i gjykoni veprime të tilla, apo

ndoshta ne i kemi parë me lupën e gabuar?

Është i drejtë konstatimi juaj për raste të tilla, megjithëse nuk janë të shumta. Kjo ndodh zakonisht kur vendimet e Këshillit janë për çështje rutinë, si ndihma ekonomike, apo çështje të tjera për të cilat me sa duket nuk ka interes nga shumica e këshilltarëve. Ndodh edhe në moment, si prag festash, pushimesh apo sezoni veror. Por, gjithsesi, kjo nuk ndodh shpesh dhe në përgjithësi unë shoh interes dhe pjesëmarrje nga ana e këshilltarëve në procesin vendimmarrës.

5. Si e gjykoni shkallën e centralizimit dhe decentralizimit të funksioneve nga pushteti qendror, ndikojnë këto procese në pavarësinë e pushtetit lokal dhe në çfarë mase, apo mënyre?

Nuk më mjafton kjo intervistë për të shprehur të plotë shqetësimin tim, por edhe të kolegëve të mi, kryetarë bashkish e komunash. Në 5 vitet e fundit ka patur një tendencë të hapur që lidhet me centralizimin e qeverisjes, si dhe me cënimin e kompetencave dhe financave të qeverisjes lokale. Janë të shumta rastet, por mjafton të përmend heqjen e çdo lloj kompetence në fushën e arsimit, në atë të shëndetësisë, dublimin e inspektoratit të ndërtimit, uljen vit pas viti të grantit, kushtëzimit të përdorimit të transfertës së kushtëzuar, futja e duarve në buxhetin e bashkive për të paguar qarkun, ose detyrimet e ujësjellësve ndaj CEZ, kufizimi me ligj i tarifave të shërbimeve, heqja e përfitimit të bashkive nga legalizimet, etj, etj kanë bërë që buxhetet e bashkive e komunave të rrudhen vit pas viti duke çuar sot në një situatë falimentimi për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, që sot nuk janë në gjendje as të paguajnë pagat e personelit.

6. Shpeshherë, gjatë monitorimit tonë kemi konstatuar se del në skenë Qarku/Prefekti. Si e cilësoni ekzistencën e këtij institucioni, sepse ndoshta është një çështje juridike, e cila na ndan edhe nga rregullimi institucional i vendeve fqinje.

Institucioni i Prefektit është i tepërt. Do të mjaftonte një zyrë juridike në qark, për të parë zbatueshmërinë e ligjeve nga qeverisjet lokale.

vijon në faqen 9 →

INTERVISTA

“Asnjë vendim nuk e kam konsideruar të vështirë për t’u miratuar, sepse për asnjë vendim nuk e kam konsideruar të domosdoshëm miratimin e tij”

vijon nga faqja 8

Krijimi i këtij institucioni është bërë thjesht për të punësuar disa njerëz nga partitë në pushtet. Kulmi i absurditetit është nënprefektura. (?) Njerëzit e kanë kuptuar qartë, se ky institucion nuk është gjë tjetër, veçse Kryetari i Partisë në pushtet, shpenzimet e të cilit përballohen nga shteti. Kjo është skandaloze. A duhen këto zyra? -Sigurisht që jo. Mbyllini ato zyra për 1 ditë, 1 muaj, 1 vit e sa të doni ju dhe do shikoni që askush nuk do ta kuptojë, gjë që tregon se ato zyra nuk i shërbejnë asnjë qyteti dhe nuk ofrojnë asnjë shërbim për qytetarin.

7. Prej disa muajsh është vënë re që ka nxitur diskutimin në këshill, pika e rendit të ditës që i takon ‘Rishqyrtimit të tarifës së ujit të pijshëm dhe të ujërave të përdorura’. Për këtë tematikë, ne kemi intervistuar edhe këshilltarë, por edhe drejtorin e UK, Pogradec. Megjithatë, në mbledhjet e mëpasme ka vazhduar të diskutohet mbi këtë problem dhe pozicionet e këshilltarëve kanë qenë të ndryshme. Cili është opinioni

apo zgjidhja juaj për rastin konkret?

Rritja e tarifës së ujit të pijshëm dhe kanalizimeve bëhet sipas një plani të studiuar dhe të miratuar kohë më parë, në bashkëpunim me KFW, që është dhe financuese e projekteve në këtë fushë. Kjo rritje bëhet krahas përmirësimit të performancës së ndërmarrjes dhe është kusht kryesor për vazhdimin e realizimit me sukses të fazës 3 të Projektit për mbrojtjen e Liqenit të Ohrid. Rritja nuk ndikon në buxhetin e familjarëve dhe të bizneseve, por thjesht i bën ata më të përgjegjshëm në shpërdorimin e ujit, që është një pasuri e paçmuar natyrore dhe që duhet kursyer nga çdokush. Qytetaret do paguajnë njesoj dhe kështu ka ndodhur pas çdo rritje çmimi, për arsyen e thjeshtë se rritet çmimi, por ulet konsumi i ujit, që sa më shumë kushton, aq më shumë kursehet.

8. Natyrisht, një nga pjesët e rëndësishme edhe për opinionin e gjerë është ‘Caktimi i Buxhetit’. Ç’mund të na thonit për realizimit tuaj nga buxheti i kaluar? A ka patur raste kur ka ndërhyrë qeveria? (si rasti i mundshëm i mospagesës së taksave operative nga ana e UK-së)

Buxheti i vitit aktual, por edhe ai që do miratojmë për vitin në vijim, nuk kanë më asgjë interesante e asgjë për të diskutuar e për tu konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit. Janë buxhete krize, që kanë degraduar në tabela të ardhurash minimale të pritshme e shpenzime minimale operative, si dhe borxhesh e detyrimesh në rritje të pashlyera. Ne jemi konsultuar me grupe interesi në hartimin e çdo buxheti, asistuar edhe nga USAID për më shumë se 5 vite me radhë. Tashmë, kjo gjë nuk ka sens. E shprehur më thjesht: nëse nuk ke asnjë mundësi financimi për asnjë projekt, nëse nuk kryen asnjë investim, përse duhet ta



pyesësh qytetarin? Nëse pas shpenzimeve minimale operative mbeten 0 lek për investime, a duhet pyetur qytetari ku do t’i investojmë këto 0 lek në dispozicion? Tashmë, koncepti buxheti i Bashkisë ka humbur kuptimin dhe është katandisur si buxheti i një familje që jeton me ndihmë ekonomike. E vetmja shpresë për të gjithë ne është viti 2013, që besoj se do jetë viti i ndryshimit të madh për gjithë Shqipërinë dhe për Pogradecin.

9. E njihni botimin tonë ‘Angazhohu – Vepra – Monitoro’, nëse jo, pse? Nëse po, cili është opinionin tuaj mbi angazhimin tonë, ndonjë sugjerim i mundshëm?

Kam lexuar disa numra të botimit tuaj. Sigurisht që më duket diçka pozitive, pjesëmarrja juaj në mbledhjet e Këshillit, po ashtu edhe botimi juaj. Dyshoj për efektin që ka patur ky botim dhe kjo pjesëmarrje e juaj në monitorimin e mbledhjeve të Këshillit, kjo jo për fajin tuaj, por për shkak të ndërjegjësisimit të pakët që kanë qytetarët për të drejtën e tyre për të qenë aktive në qeverisjen vendore. Ka një pjesëmarrje të ulët të qytetarëve në të gjitha ftesat që u janë bërë nga ana jonë, por edhe në realizimin e të drejtës së tyre për të qenë pjesë aktive e kësaj qeverisje. Nevojitet më shumë sensibilizim!

-Ju falenderoj shumë për interesin dhe gatishmërinë tuaj!



PUSHTETI VENDOR

Buxheti me pjesëmarrje

ÇFARË ËSHTË BUXHETIMI ME PJESËMARRJE

Është një mekanizëm i thjeshtë që përfshin të gjithë komunitetin, burra dhe gra, shtresat tradicionalisht të përjashtuara në sigurimin e aksesit ndaj fondeve publike dhe në procesin e vendim-marrjes

Është një proces në të cilin përcaktohen prioritetet dhe realizohet vendim-marrja e përbashkët mes komunitetit dhe qeverisjes vendore, të cilët vendosin bashkërisht përcaktimin përfundimtar të investimeve dhe shërbimeve, brenda burimeve të kufizuara.

Pse duhet pjesëmarrja e SHC në proceset vendimarrëse të njësisë vendore

- SHC përbën një mjet për të njehsuar dëshirat dhe nevojat e grupeve qytetare
- Shërben për të ushtruar influencë mbi qeverisjen, së LAG ka natyrë jo-qeveritare
- I bën vendimet të pranohen me më pak veshitësi nga publiku
- Lejon që të kuptohet më mire se çfarë kërkojnë e presin qytetarët
- Motivon të tjerët të angazhohen
- Forcon besimin e qytetarëve tek qeverisja
- Promovon një këshill vendor transparent

SI TË NDIKOJË SHC NË PROCESIN E BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE

Organizimi i procesit: (Njësi vendore dhe SHC hartojnë një kalendar për procesin e përgatitjes së buxhetit me pjesëmarrjen e qytetarëve)

Mbledhje të hapura për prioritetet qytetare : SHC bashkë me njësinë

vendore organizojnë takime me publikun për mbledhjen e kërkesave të tyre për investime e shërbime

Parashikimi i të ardhurave (Drejtorja e tatim-taksave dhe Financës parashikon të ardhurat e mundshme: të ardhurat e veta dhe transfertën e pakushtëzuar të Q.Qëndrore)

Kërkesat e departamenteve/qytetarëve: Mblidhen të gjitha kërkesat në tryezë

Shqyrtohen kërkesat nga financa dhe kryetari i Njësisë Vendore dhe SHC: Vendosen kriteret për prioritizimin e tyre

Përgatitet projekt-buxheti : Krahasohen burimet e fondeve me projektet e prioritizuara dhe vendoset numri i atyre që do të mbështeten me buxhet

Shqyrtohet drafti i buxhetit nga komisionet e këshillit dhe këshilli: SHC mund të jetë vëzhgues në këto diskutime të komisionit

Debat publik mbi buxhetin e propozuar : Drafti mbas vërejtjeve të këshillit paraqitet në public dhe reflekton vërejtjet



Miratohet dokumenti i buxhetit nga Këshilli dhe SHC merr pjesë në mbledhjen e hapur të këshillit për buxhetin

Zbatimi/ndjekja e buxhetit : Buxheti i miratuar zbatohet nga njësi vendore. SHC monitoron zbatimin e buxhetit

ORGANIZIMI I PROCESIT TE BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE

1. Që kjo iniciativë të konkretizohet kërkohet angazhimi dhe dëshira e qytetarëve për të marrë pjesë në caktimin e prioritetëve. Pra, duhet sensibilizimi i tyre
2. Njësi ndahet në zona/lagje/ fshatra
3. Takimet organizohen në vende afër njerëzve
4. Takimet drejtohen nga SHC dhe të zgjedhurit lokale (marrin pjesë dhe këshilltarë)
5. Prezantohen nga njësi vendore ato që janë bërë vitin e kaluar dhe projekte që janë në vazhdim
6. Pjesëmarrësit propozojnë nevojat që kanë në zonën e tyre
7. Regjistrohet çdo propozim në një tabelë
8. Pjesëmarrësit votojnë për tre investime që ju duken më të rëndësishme
9. SHC evidenton nga votimi ato investime që kanë marrë më shumë vota dhe shpall listën përfundimtare të votuar

fondet e mundshme për te mbështetur investimet

13. Komisioni dhe SHC zgjedhin listën e investimeve sipas burimeve të mundshme

14. Bëhet verifikimi në vend i investimeve që mund të përfshihen në buxhet

14. SHC përgatit një relacion për njësinë/këshillin vendor për mënyrën e përzgjedhjes së investimeve

15. Njësi vendore përgatit buxhetin dhe shpjegon procesin e përzgjedhjes në Këshill

KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E INVESTIMEVE PRIORITARE

Përzgjedhja nga SHC dhe komisioni, sëbashku me stafin i investimeve prioritare bëhet mbi bazën e disa kriterëve , që i përcaktojnë së bashku. Ai investim që plotëson më shumë kriterë fiton për tu përfshirë në buxhet. Disa kriterë që përdoren :

1. Ka burime të sigurta qëndrore ose është kërkesë ligjore
2. Është projekt në vazhdim
3. Është objektiv i këshillit apo i dokumentave qytetare
4. Rregullon një gjendje të rrezikshme për shëndetin, sigurinë
5. Ka jetëgjatësi më shumë se 20 vjet
6. U shërben të paktën 50% të banorëve
7. Siguron të ardhura që ulin kostot e mirëmbajtjes
8. Ka impakte pozitive të zhvillimit ekonomik dhe mbështetjet nga biznesi e komuniteti. Etj.

ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË ZBATIMIN E BUXHETIT

Mbas vendimit të Këshillit ,SHC zgjedh 1-2 investime për t'i monitoruar. Konkretisht verifikon:

-Treguesit juridikë: psh afatet kohore, afatet e likuidimit, sanksionet

-Treguesit fizikë (sa ml rrugë, trotuare rrugë, ndriçim, tubo të çfarë përmasave..etj sipas preventivit

-Treguesit financiarë (kostua) -Bëj konkluzione, çfarë duhet korrigjuar

10. Çdo fshat apo zonë zgjedh një përfaqësues që do të jetë pjesë e komisionit, ku do të zgjidhen ato investime që janë më prioritare

11. SHC, përfaqësuesit e zgjedhur dhe stafi i Bashkisë përcaktojnë me konsensus disa kriterë për të përzgjedhur prioritetet

12. SHC kërkon informacion për

QUITZ

KY PYETËSOR SYNON TË TESTOJË INFORMIMIN E QYTETARËVE PËR KOMISIONET E KËSHILLIT TË BASHKISË

Shëno në kllapat bosh (E Vërtetë) ose (E Gabuar) për fjalitë e mëposhtme!

(Shkëputur nga Neni 17)

- Komisionet janë organe të këshillit dhe kryejnë funksionet për njohjen e gjendjes, realizimin e iniciativës dhe të kontrollit të Bashkisë.

(_____)

- Komisionet janë të përhershme ose të përkohshme.

(_____)

(Shkëputur Neni 18)

Të krijohen dhe të funksionojnë këto komisione të përhershme:

1. Komisioni i mandateve dhe i marrjes së vendimit.

(_____)

2. Komisioni juridik dhe i rendit.

(_____)

3. Komisioni i ekonomisë dhe tregëtisë.

(_____)

4. Komisioni i strehimit dhe i zhvillimit rural.

(_____)

5. Komisioni i problemeve sociale dhe i punësimit.

(_____)

6. Komisioni i arsimit, kulturës, sporteve dhe shendetit.

(_____)

7. Komisioni i mjedisit dhe i urbanistikës.

(_____)

(Shkëputur nga Neni 19)

- Numri dhe anëtarët e komisioneve zgjidhen nga anëtarët e bordit drejtues të Bashkisë me votim të mbyllur, me propozim të kryetarit të Këshillit Bashkiak, mbas konsultimit paraprak me anëtarët e grupeve.

(_____)

- Drejtuesit e komisioneve, kryetarët, zv/kryetarët zgjidhen nga kryetarët e komisioneve.

(_____)

- Çdo këshilltar mund të zgjidhet anëtar deri në tre komisione të përhershme të këshillit.

(_____)

- Kryetari dhe zv/kryetari i këshillit të Bashkisë nuk mund të bëjnë pjesë në komisionet e përkohshme.

(_____)

- Drejtuesit e komisioneve koordinojnë punën dhe mbajnë lidhje me njëri tjetrin, si dhe me drejtuesit e Këshillit të Bashkisë.

(_____)

- Gjithashtu këto grupe anëtarësh shqyrtojnë raportet, njoftimet dhe relacionet që paraqet për këshillin Bordi Drejtues i Bashkisë.

(_____)

(Shkëputur nga Neni 21)

- Nëpunësit e administratës së Bashkisë, si dhe ata të ndërmarrjeve dhe institucioneve, që varen prej sa duhet t'ju venë në dispozicion të gjitha të dhënat komiteteve dhe anëtarëve, kur u kërkohen në përputhje me aktet ligjore përkatëse.

(_____)

(Shkëputur nga Neni 22)

- Komisionet e përkohshme mbledhen prej kryetarit dhe zv/kryetarit të tyre, me kërkesën e gjysmës së anëtarëve, ose me kërkesën e kryetarit të Bashkisë.

(_____)

- Paraqitësi i projekteve në këshill merr pjesë në komisionet e përhershme në kohën e shqyrtimit të tyre, duke caktuar përfaqësuesit e vet, të cilët japin sqarimet e nevojshme.

(_____)

- Mbledhjet e komisioneve janë të vlefshme kur marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve.

(_____)

- Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në votim të mbyllur.


(Shkëputur nga Neni 23)

- Komisionet e përhershme mund të organizojnë dhe mbledhjet e përbashkëta dhe drejtohet nga njëri nga anëtarët e komisioneve, me mirëkuptim.

(_____)

- Çdo anëtar i komitetit merr vendime, veçmas për çështjet e shqyrtuara.

(_____)



(Shkëputur nga Neni 20)

- Komisionet e përhershme përgatisin plane, projekt-urdheresa, etj dhe ia paraqesin Këshillit të Bashkisë për votim.

(_____)

- Komisionet e përkohshme diskutojnë projektet e përgatitura dhe të shpërndara nga kryetari i i këshillit, përgatisin raportet për to dhe i propozojnë Këshillit të Bashkisë pranimin ose jo, të projekteve, ndryshimin dhe plotësimin e tyre.

(_____)

Punoi: Ana Capo

Letër publike

I dashur Qyteti im



Udhëve teje Qyteti im, përpos kënaqësisë dhe sedër-përkëdheljes që fitojmë kur soditim bukurinë tënde dhe krenarinë e rritjes së menjëhershme dhe mirëorganizimit tënd, dëgjoj pëshpërimita ankesash të shurdhra, të cilat duhet të drejtohen në derën e duhur, në mos në faqet e botimit tonë të hapur dhe mirëpritës.

Jo të pakta janë edhe pakënaqësitë e qytetarëve nga pakuptimësitë e vendimeve që merren në emër të tyre, ndjesi këto që denigrojnë deri në debate tavolinash dhe rrugësh, por pa u dëshmuar siç duhet në zyrat e pushtetit lokal, kontakteve me deputetin (qoftë edhe sikur të duhet të gjurmohet me ditë ose muaj), apo në pritjet e nëpunësve të organeve qendrore.

Gjatë monitorimit tonë kemi trajtuar problematika të

rëndësishme dhe me një lupë sa më të hollësishme, jo vetëm për të realizuar detyrën tonë, por edhe për të afruar qytetarët (qoftë edhe në mënyrë apo taktika të imponuara, si gazeta Nositi, botimi i suplementit “Angazhohu-Monitoro-Vepro”, aktivitete të shoqatës “Unë, Gruaja”, monitorim dhe publikim nga televizioni lokal SOT-7, etj), vetëm për të ndërgjegjësuar masën mbi pjesëmarrjen në vendimmarrjen e pushtetit lokal dhe më gjerë.

Ndoshta çështjet që parashtröjmë nuk paraqesin interesin e duhur gjithëpërfshirës (për ju), por nuk mund të heshtim ndaj këtyre të fundit, sepse përbëjnë bazën e funksionimit të qytetit dhe për më tepër, gatiten për t’u hedhur në kolonat e artikujve tanë, pasi kanë kaluar fazën e diskutimeve dhe opinionëve mbi votimin e këshilltarëve, stafit vullnetar të angazhuar (me aktorë të larmishëm opinionistësh), por edhe qytetarë të interesuar (kryesisht funksionarë në pushtet).

Nuk e kuptoj sesi mund të qëndrohet indiferent kur kërkohet përfshirja e strehës familjare për ndihmë sociale, rritja e kësaj të fundit, apo qoftë edhe përjashtimi prej saj.

Mos ndoshta çështja e buxhetimit ka më pak rëndësi?!

A e dini se si janë shpenzuar deri tani mjetet financiare në dispozicion?

A e dini sa është caktuar buxheti për këtë vit?

A e dini si do të shpërndahen mjetet e lëmshës për investimet lokale?

A e dini se bukuria e qytetit tonë nëse nuk ka financat e nevojshme, nuk do t’i mjaftohet petku natyror për të ruajtur hijeshinë e tij dhe jo më për mirëmbajtjen e kostumografisë së pashoqe që i është vënë, e cila natyrisht do të jetë shumë jetëshkurtër dhe do të venitet si një vdekje e ngadaltë, kur të mos investohet në përkujdesjen e mëtejshme.

Ah po, një rëndësi e veçantë te numrat e buletinit tonë i është kushtuar problematikës së rritjes së tarifës së ujit nga ana e UK-së. Këshilltarët kanë shpalosur mendimet e tyre, si në mbledhjet e këshillit, ashtu edhe në botimin tonë, por ju Qyteti im i dashur, e dini si zgjidhet kjo çështje?

A e dini vallë që nëse rritet tarifa e ujit, do ju duhet të mirëkurseni konsumin e ujit dhe nëse nuk rritet tarifa, atëherë rrezikojmë të humbasin financuesen kryesore KFW, largimi i së cilës mund të çojë në dështimin e fazës së tretë të projektit për liqenin. Atij ‘liqeri’, të

cilit i rrëfehemi çdo mbrëmje stinësh dhe e përshëndesni çdo mëngjes pune dhe pushimi, nuk i keni kaq pak borxh interesimin?

Tema diskutimetsh si: Besim i ulët te strukturat udhëheqëse vendore dhe lokale, vendimmarrje fiktive, dyer të mbyllura, vendime të gabuara, etj, ndoshta janë reale dhe të vërteta qytetarë të nderuar, por asgjë nuk do të zgjidhet apo sqarohet, nëse vendosni të qëndroni veçmas dhe indiferentë, pa treguar kujdes dhe pa u përfshirë në dhënien e mendimeve, të cilat me instrumentat e duhura mund të dëgjohen dhe përmirësohen në kohë. Nuk duhet pritur takimi i përvitshëm me krerë partish, për të shfryrë dufin e moskuptimit apo pakënaqësitë tuaja, të cilat burimin mund ta kenë edhe nga mosinformimi apo refuzimi i pjesëmarrjes suaj kur ju kërkohet nga strukturat e vendimmarrjes.

Ndaj, ejani me ne dhe le të nisim fillimisht me monitorimin e mbledhjeve të këshillit bashkiak, duke bashkëpunuar me të për interesat e qytetit tonë dhe më pas, le të fillojmë të drejtojmë pyetjet e duhura te subjektet përkatëse përgjegjëse!

*Me konsideratën më të lartë,
Biri juaj Dorian Leka*

